



# NJOFTIM PËR KONTRATË

(*Ri-tender*)

*Kontratë Furnizimi*

*Procedurë e hapur*

Në përputhje me nenin 10, "Procedura e hapur" të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024)

Data e shpalljes: 31.07.2025

Nr. i Prokurimit: "BQK 25 042.1 121"

## I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK	
Adresa: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: +383 38 222 055/451	

## II LËNDA E KONTRATËS

### II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Furnizimi me një veturë pick-up-Ri-tender"
Lloji i prokurimit: Kontratë furnizimi
Vendi kryesor i realizimit: Prishtinë
Informacione të marrëveshje afatgjatë: n/a
Variantet pranohen: Jo
Lloji i procedurës: Procedurë e hapur
Vlera e parashikuar e kontratës: 35,000.00 Euro

Ndarja në Pjesë: Jo

### III INFORMACIONE PËR SHERBIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhen kontraktuesit të cilët do të realizojnë në mënyrë profesionale furnizimin me një veturë për bartje pick-up - sipas specifikave teknike dhe funksionale të parapara në Dosjen e Tenderit.

### IV KRITERET E PËRZGJEDHJES<sup>1</sup>/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim. **Vëmendje për operatorët ekonomik që t'i kenë parasysh kërkesat sipas tabelës në vijim rreth vendosjes së evidencave/dëshmime në ofertat e tyre.**

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – <i>Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 kur aplikohet) janë të obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i>	<b>Kërkesa 1:</b> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë. <b>Evidenca 1:</b> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin përkatës i cili gjendet në dosjen e tenderit.
	<b>Kërkesa 2:</b> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C. <b>Evidenca 2:</b> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.
	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në Kërkesat 1, 2 dhe 3 të kësaj table. <b>Kërkesa 3:</b> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium) <b>Evidenca 3:</b> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë tenderimi. Në rast se një anëtar i një grupi tenderues merr pjesë në dy apo më tepër grupe për të njëjtin tender, secili nga grupet përkatëse ku është i përfshirë ky

<sup>1</sup> Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

	<p>anëtar do të konsiderohet i papërgjegjshëm dhe përjashtohen si të tilla. Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë.</p> <p>Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të Rregullës për Prokurimin në BQK. Kurse kërkesat për kriteret e përzgjedhjes që kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik e profesional, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të konzorciumit.</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë e profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><b><u>Kërkesa 4:</u></b> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Evidenca 4:</u></b> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Kërkesa 5:</u></b> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><b><u>Evidenca 5:</u></b> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><b><u>Kërkesa 6:</u></b> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><b><u>Evidenca 6:</u></b> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6 të kësaj tablele.</p>
<p>Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>Nuk aplikohen</p>
<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale</p>	<p><b><u>Kërkesa 7:</u></b> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy kontrata të natyrës se ngjashme përgjatë 3 (tri) viteve të fundit (2022, 2023 dhe 2024, përfshirë edhe 2025 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë).</p> <p><b><u>Evidenca 7:</u></b> Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi:</p>

<p>– Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 7, 8 dhe 9) mund të kërkohen dokumentacion plotësues ose sqarime</p>	<p>a) certifikatat relevante të pranimit të furnizimit ose referencat që evidentojnë realizimin e furnizimit të tillë dhe b) kopjet e kontratave përkatëse</p> <p><b>Kërkesa 8:</b> Ofertuesi duhet ta plotësojë formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit. <b>Evidenca 8:</b> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me furnizimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit (2022, 2023 dhe 2024, përfshirë edhe 2025 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë) duke saktësuar shërbimet e realizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej furnizimeve.</p> <p><b>Kërkesa 9:</b> Ofertuesit duhet të dorëzojnë Katalogun-me specifika teknike, detaje të automjetit të ofruar (sipas kërkesës në tabelën e specifikave teknike). <b>Evidenca 9:</b> Katalogu me specifika teknike të automjetit të ofruar të ketë të shënuar qartë produktin e ofruar, ashtu siç është kërkuar në specifikat teknike</p>
--	--

## V

V.1 Lloji i procedurës: “Procedurë e hapur”, sipas Nenit 10 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (dhjetor 2024).

## VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS:

“Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të ulët”, në përputhje me nenin 34 të Rregullës së prokurimit në BQK.

## VII INFORMATA ADMINISTRATIVE PËR OFERTUESIT

<p>Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 08.08.2025, ora 12:00 në e-mail adresën: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>.</p>
<p>Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 08.08.2025, ora 14:00 në e-mail adresën: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>.</p>
<p>Afati i fundit dhe vendi i dorëzimit të ofertave, data: 14.08.2025, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.</p>
<p>Takimi për hapjen e ofertave, data: 14.08.2025, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr.“Garibaldi” nr.33, Prishtinë.</p>
<p>Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): 1,000.00 € (një mijë euro) me vlefshmëri prej 90 ditësh nga data e hapjes së ofertave</p>
<p>Kushti i sigurimit të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.</p>

Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes së ofertës.
---

Dokumentet me pagesë: Jo
--------------------------

## VIII. ANKESAT

<p>Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.</p>
--

## IX. ADRESA

Rr. “Garibaldi” 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763